Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 17, paragrafi 1, shkronja (e) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikes së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 10, pika 1.5, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012", nenit 20, pika 7 dhe 11, të Rregullores QRK, Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave te dhënies ne shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 27.03.2018, miratoi këtë:

# V E N D I M
## PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E TRAFOSTACIONEVE DHE DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

### Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni **për vendosjen e trafostacioneve TSS1111 nga KEDS-si dhe dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, për këto fshatrat si më poshtë;**

1.1 Në fshatin Mushtisht në parcelën kadastrale **P-72116029-00333-1,** me sipërfaqe e përgjithshme prej; **39886m²,** sipas certifikatës së pronës nr.**952-2/2018827,** datës 15.02.2018, zona kadastrale **Mushtisht**, vendi i quajtura **"Nerezine"**, evidentuara pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **19m²** për vendosjen e trafostaconit,

1.2 Në fshatin Dobërdelan në parcelën kadastrale **P-72116016-02525-0,** me sipërfaqe e përgjithshme prej; **7551m²,** sipas certifikatës së pronës nr. 1186, datës 02.02.2018, zona kadastrale **Dobërdelan**, vendi i quajtura **"Çuka"**, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **9m²** për vendosjen e trafostaconit.

1.3 Në fshatin Bukosh në parcelën kadastrale **P-72116005-01419-0,** me sipërfaqe të përgjithshme prej; **11654m²,** sipas certifikatave të pronës nr. 1138-2018, datës 02.03.2018, zona kadastrale **Bukosh I**, vendi i quajtura **"Fshat"**, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **9 m²** për vendosjen e trafostaconit,.

### Neni 2

Pronat e cekura në nenit 1, të këtij vendimi jepen ne shfrytëzim pa kompensim ne afat per 99 (nente dhjetë e nëntë) vite.

## Neni 3

**3.1** <u>**OBLIGOHET**</u> shfrytëzuesi i cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme të cekur në nenin 1.1 deri 1.3, të këtij vendimi, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

**3.2** Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

**3.3** Komuna e Suharekës e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës për realizimin e interesave publik të Komunës të ndryshoj lokacionin në një vend tjetër.

## Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis e Komunës së Suharekës, të cilat do të bëjnë parcelizimin dhe skicimin në teren për vendosjen e trafostacionit dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.

## Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

**K U V E N D I  I  K O M U N Ë S – S U H A R E K Ë**

01-Nr-101-13992
Më datë 28.03.2018

Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI